



Prishtinë: 16.04.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1138_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1901_02_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **26.03.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 16.04.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin V. J. nga Fushë Kosovë, me shifër të konsumatorit DPR 90077374, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1901_02_19** i datës 25.02.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 26.03.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se faturimi i shërbimeve në vlerë prej 116.00 € është bërë në emër të kyçjes së re dhe se pas faturimit konsumatori ka qenë në dijeni dhe me vullnet të lirë e ka bërë pagesën. Në ankesë është theksuar se konsumatori tek me datë 06.11.2015 ka parashtruar ankesë në lidhje me këtë shërbim. Në ankesë është theksuar se pagesa është bërë nga ana e konsumatorit në llogari të KEK që ka qenë përgjegjëse gjatë kësaj periudhe për operim të distribucionit dhe furnizimit, dhe se vendimi i DMK në ZRRE i është drejtuar KESCO-s për korrigjim të shërbimeve në vlerë prej 116.00€. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1901_02_19 i datës 25.02.2019 për konsumatorin V. J. me shifër DPR - 90077374 dhe të mbetet në fuqi faturimi në kartelën e konsumatorit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 16.04.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s faturimi i shërbimeve në vlerë prej 116.00 € është bërë në emër të kyçjes së re dhe se pas faturimit konsumatori ka qenë në dijeni dhe me vullnet të lirë e ka



bërë pagesën, Bordi i ZRRE thekson se sipas dispozitave ligjore të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me energji dhe Procedurës lidhëse të gjithë aplikuesit të cilët parashatrojnë kërkesa për kyçje në rrjetin elektrik janë të obliguar të bëjnë edhe pagesën e taksës për kyçje në rrjet, pra janë të obliguar të paguajnë për shërbimin e lidhjes/kyçjes së re, e që në këtë taksë përfshihet pjesa e kapacitetit të ngarkuar dhe pjesa e kyçjes. Mirëpo Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës, respektivisht Pëlqimit Elektroenergjetik nr.2683 të datës 15.06.2009 të KEK dhënë Drejtoratit të Shërbimeve Publike, Komuna e Fushë Kosovës për objektin e banimit të rasteve sociale "Kompleksi 300" dhe Pëlqimin Elektroenergjetik nr.3679 të datës 26.07.2011 (Pëlqimi i reviduar) të KEK dhenë Drejtoratit të Shërbimeve Publike, Komuna e Fushë Kosovës, ka vërejtur se në Pëlqimin Elektroenergjetik nr.221/09 të datës 15.06.2009, përveç kushteve teknike të dhëna, në pikën 8 të këtij PEE është theksuar se në emër të fuqisë së angazhuar, zgjerimit të kapaciteteve prodhuese, bartëse dhe distributive, investitori është i obliguar të KEK, Divizionit të Rrjetit t'i paguaj shumën prej 6,820.80€, dhe se në këtë vlerë është përfshirë fuqia e angazhuar, taksa e kyçjes dhe TVSH-ja. Pra shihet qartë se PEE nr.221/09 e datës përfshin në vete taksën e kyçjes dhe se sipas kësaj investitori i ndërtimit të këtyre ndërtesave e ka bërë pagesën e kyçjes në rrjetin elektrik. Bordi i ZRRE gjithashtu ka analizuar edhe PEE nr.3679 të datës 26.07.2011 (Pëlqimi i reviduar), dhe se në pikën 7 të këtij PEE është përcaktuar se për fuqinë e angazhuar, zgjerimit të kapacitetit prodhues, bartëse dhe distributive, gjatë regjistrimit të njehsorëve elektrik të konsumatorëve do të aplikohen tarifat e KEK për konsumatorët e rinj. Sa i përket pikës së kundërshtimit të KEDS se konsumatori ka qenë në dijeni për këtë shërbim dhe e ka paguar me vullnet të lirë, duhet theksuar se konsumatori e ka paguar për shkak se KEK në atëkohë e ka ngarkuar me këtë taksë dhe se nuk ka qenë në dijeni se kjo taksë është paguar nga investitor.

Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka analizuar edhe shkresën e organit të shkallës së parë në ZRRE (DMK në ZRRE) drejtuar KEDS duke kërkuar informata shpesh mbi konsumatorët e objektit banesor "Kompleksi 300" për të cilët nuk është faturuar shërbimi për lidhje të re në vlerë 116.00€ dhe përgjigjen e KEDS dhënë organi të shkallës së parë të ZRRE-së. Bordi i ZRRE ka vërejtur se KEDS i është përgjigjur ZRRE-së se investitorit Drejtoratit të Shërbimeve Publike, Komuna e Fushë Kosovës i është lëshuar PPE nr.3679 i datës 26.07.2011 për dy objektet e banimit me numër total prej 76 banesave përkatësisht PEE ka përfshi 76 njehsor elektrik dhe se konsumatorët përfitues të këtyre banesave janë liruar nga pagesa e shërbimeve për lidhje të re në vlerë 116.00€. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se vet KEDS në shkresat e veta ka konstatuar se investitori i ndërtimit të këtyre objekteve banesore ka bërë pagesën për kyçje/lidhje të re, dhe se konsumatorët nuk duhet të ngarkohen me taksën prej 116.00€, respektivisht duhet të lirohen nga kjo taksë.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se pagesa e për taksën është bërë nga ana e konsumatorit në llogari të KEK që ka qenë përgjegjëse gjatë kësaj periudhe për operim të distribucionit dhe furnizimit, dhe se vendimi i DMK në ZRRE i është drejtuar KESCO-s për korrigjim të shërbimeve në vlerë prej 116.00€, Bordi i ZRRE thekson se me rastin e privatizimit të aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit nga KEK në KEDS në maj të vitit 2013, kompania e re KEDS ka marrë nga ZRRE vetëm transfer licence për këto aktivitete, dhe si të tillë për konsumatorin nuk është me rëndësi se a ka qenë KEK në atë kohë apo KEDS/KESCO. Andaj Bordi i ZRRE-së thekson se përderisa KEK në atë kohë dhe pastaj edhe KEDS kanë gabuar kur i kanë ngarkuar konsumatorët me këtë taksë atëherë edhe duhet të korrigjojnë gabimin e bërë. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së thekson se taksa për lidhje të re e ngarkuar te konsumatori në shifrën DPR – 90077374 është paguar nga investitori sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të cekur më lartë dhe se konsumatori nuk duhet të paguaj për taksën për lidhjen e re, respektivisht të shkarkohet nga ajo taksë, përderisa investitori e që në këtë rast ka qenë Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë në Komunën e Fushë Kosovës e ka paguar, si dhe kjo është pohuar edhe në përgjigjen e vet KEDS-it.



Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16.04.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit V. J. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.